



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 14 datë 20.7.2023**

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2023 E MIRATUAR ME “VENDIMIN E
KËSHILLIT BASHKIAK NR.71 DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË
VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2023 –
2025 TË BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli i Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 20.7.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, neni 54 shkronja “dh” i ndryshuar; ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratime procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” i ndryshuar, neni 3,3.1, gërmat a,b,dh, ligji nr.68/2017 ‘Për financat vendore’i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ; Udhëzimi Plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” i ndryshuar ; shkresës nr.86/6 prot. datë 27.03.2023 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” të Ministrisë së mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”; shkresës nr.4429/1 prot. datë 29.03.2023 “Kthim përgjigje Ministrisë së Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile te shkresës me nr. 86/6 prot. datë 27.03.2023 me objekt “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” nga Bashkia Shkoder ; shkresës nr.9022/2 prot. datë 15.06.2023 “Miratim limiti ” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë marrë nga Dega e Thesari Shkodër, VKB nr.27 datë 04.04.2023 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare të familjeve banesat e të cilëve u janë dëmtuar nga zjarri, ”VKB nr. 71 , datë 27.12.2022 “Për miratimin

e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër“ , i ndryshuar , dhe relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

I. Të miratojë shtesën e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2023 alokuar në programin 10910 “ Emergjencat Civile “ si më poshtë:

- 1.Për kod produkti 91707AG – “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me vlerë **13,000,000 lekë**.
- 2.Për kod produkti 91707AB – “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” me vlerë **8,371,526 lekë**.
- 3.Për kod 18AZ901 – Shtesë në zërin shpenzime kapitale me objekt “ Fatkeqësi natyrore të menaxhuara “ Reduktim i pasojave të permbytjes në zonën e nën Shkodrës “ me vlere **16,420,631 lekë**.

II. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet të cilëve u janë dëmtuar banesat nga zjarri me kod produkti 91707AB “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” si më poshtë:

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Saimir Laqja** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 292 122 (dyqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e njëzet e dy) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 254 400 (dyqind e pesëdhjetë e katërmijë e katërqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Saimir Laqja** .
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **znj. Mri Marku** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 26 250 (njëzet e gjashtëmijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 68 600 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **znj. Mri Marku** .
3. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Pjetër Mhillaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 375 601 (njemilion e treqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e një) lekë dhe në orendi,

mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 508 180 (pesëqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Pjetër Mhillaj** .

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Nikolin Gojçi** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 304 195 (treqind e katërmijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) leke dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 327 800 (treqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Nikolin Gojçi**.

Tabela e përfitimit sipas dëmeve është:

N r	Emri familjes	Vlera ndërtimore	Vlera e orendive	Vlera ndërtimore dhe e orendive	50 % Vlera ndërtimore	50 % Vlera e orendive	50 % Vlera ndërtimore dhe e orendive	Humbja e jetës	Dëmshpërbli m për humbje jete
		1	2	2 + 3	4	5	4 + 5		
1	Saimir Laqja	292 122	254 400	546 522	146 061	127 200	273 261	-	-
2	Mri Marku	26 250	68 600	94 850	13 125	34 300	47 425	-	-
3	Pjetër Mhillaj	1 375 601	508 180	1 883 781	687 800.5	254 090	941 890.5	-	-
4	Nikolin Gojçaj	304 195	327 800	631 995	152 097.5	163 900	315 997.5		
	Shuma	1 998	1 158	3 157	999	579	1 578		-
	përfundimtare	168	980	148	084	490	574		

III. Fondi i mbetur në shumën 6,792,952 lekë të jetë gjëndje për përballimin e dëmeve të vlerave ndërtimore dhe orendive deri në masën 50% të vlerës së dëmit për raste të

paparashikuara, si dhe për raste të tjera të paparashikuara për emergjencat civile gjatë vitit 2023.

IV. Të miratojë shpenzimet për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me kod produkti 91707AG me vlerë 13,000,000 lekë si më poshtë:

1-“Shërbime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë si rezultat i fenomeneve natyrore” me vlerë 3,250,000 lekë

2-“Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative, Bashkia Shkodër” me vlerë 3,000,000 lekë

-**Loti I-rë** : *“Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative, Bashkia Shkodër” 1,100,000 lekë*

-**Loti i II-të**: *“Shërbime për mirëmbajtje emergjente të segmentit “Ura Mesit - Prekal - Kir - Mali Shoshit - Breglumi - Nderlytaj - Thethë” me vlerë 1,900,000 lekë.*

3-“Dispozicion karrotrec për nevoja emergjente” me vlerë 600,000 lekë.

4-“Blerje produkte ushqimore dhe detergjente për familje në nevojë” në shumën 3,000,000 lekë.

5-“Blerje koncentrat për blegtorinë” në shumën 3,000,000 lekë.

6-“Blerje thasë rëre për mbrojtje nga përmbytjet” në shumën 150,000 lekë

V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

7.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 39 vota

Vota Pro 39

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 24.7.2023